



WORCESTER PUBLIC SCHOOLS

GREGORY BARES
MANAGER OF GRANT RESOURCES/
TITLE I DIRECTOR

DR. JOHN E. DURKIN ADMINISTRATION BUILDING
20 IRVING STREET
WORCESTER, MASSACHUSETTS 01609-2493
PHONE (508) 799-3108 FAX (508) 799-8158

Informacion në lidhje me Ligjin e Arsimit Elementar dhe Sekondar (*Elementary and Secondary Education Act*) (ESEA) [Seksioni 1112(e)(1)(A)] dhe Ligjin Cdo Nxënës ka Sukses (*Every Student Succeeds Act*) [Seksioni 1112(e)(1)(A)]

Gusht 2019

Të Dashur Prindër/ Kujdestarë Ligjorë:

Fëmija juaj ndjek një shkollë e cila merr fonde sipas Federal Title I, për ti ndihmuar nxënësit në arritjen e standarteve të larta akademike. Ne po ju ofrojmë informacion të rëndësishëm rreth këtij ligji dhe arsimit të fëmijës tuaj. Kjo letër ju njofton rreth të drejtës tuaj për të kërkuar informacion rreth kualifikimeve të stafit të klasës që punon me fëmijën tuaj.

Ne jemi shumë krenarë për mësuesit tanë dhe mendojmë se ata/ ato janë gati për vitin shkollor që po fillon dhe janë të përgatitur për ti dhënë fëmijës tuaj një arsimim me kualitet të lartë. Si një shkollë e Title I, ne duhet që të përmbushim rregullat federale në lidhje me kualifikimet e mësuesve sipas përcaktimit të ESEA. Këto rregulla u lejojnë ju që të mësoni më shumë rreth trajnimeve dhe kredencialeve të mësuesve të fëmijës tuaj. Ne jemi të lumtur t'ju ofrojmë këtë informacion. Në çdo kohë, ju mund të kërkon:

- Nëse mësuesi(ja) përmbush kualifikimet e shtetit dhe çertifikimet e kërkuara për nivelin e klasës dhe subjektin që ai/ ajo po jep mësim.
- Nëse mësuesi(ja) ka marrë një çertifikatë emergjence ose të kushtëzuar nëpërmjet së cilës kualifikimet e shtetit nuk u morën parasysh, dhe
- Cfarë diplome kolegji ose masteri ka mësuesi(ja), përfshirë çertifikatat e diplomimit dhe gradat e tjera, dhe fushën(at) ose temën(at) e fokusimit.

Ju gjithashtu mund të pyesni edhe nëse fëmija juaj merr ndihmë nga një para-profesionist. Nëse fëmija juaj e merr këtë ndihmë, ne mund t'ju ofrojmë informacion rreth kualifikimeve të para-profesionistëve.

Ligji Cdo Nxënës ka Sukses (Student Succeeds Act) (ESSA), i cili u firmos si ligj në Dhjetor 2015 dhe riautorizon Ligjin e Arsimit Elementar dhe Sekondar të vitit 1965 (ESEA), përfshin dispozita shtesë që lidhen me të drejtën e njohjes së kërkesave. Prindërit dhe anëtarët e familjes mund të kërkojnë:

- Informacion mbi rregulloret që lidhen me pjesëmarrjen e nxënësit në vlerësime/ testime
- Informacion mbi vlerësimet/ testimet e kërkuara që përfshijnë
 - lëndën e tesuar,
 - qëllimin e testit,
 - burimet e kërkesës (nëse është e aplikueshme),
 - kohën që u duhet nxënësve për të përfunduar testin
 - kohën dhe formatin e dhënies së rezultatit

Stafi jonë është i angazhuar për të ndihmuar fëmijën tuaj që të zhvillojë njohuritë akademike dhe mendimin kritik që ai/ ajo ka nevojë për të pasur sukses në shkollë dhe përtej saj. Ky angazhim përfshin edhe garantimin që të gjithë mësuesit dhe para-profesionistët tanë përmbushin kërkesat e aplikueshme të shtetit dhe ato federale.